



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC

**SHPLLJE PËR NËPUNËS CIVIL PËR LËVIZJE PARALELE  
DHE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË  
EKZEKUTIVE**

**Pogradec më 17 / 06 / 2019**

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, të Vendimit Nr. 243, datë 18/03/2015, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” të Këshillit të Ministrave, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore pranë Bashkisë Pogradec shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, për pozicionet:

**1 (Një) Pozicion – Specialist për projektet e infrastrukturës dhe planifikimit të territorit, Kategori e pagës IV-a.**

**1(Një) Pozicion-Specialist për inspektimin e zhvillimit dhe kadastrën urbane-Kategori e pagës IV-a**

**1( Një) Pozicion-Specialist për inspektimin e zhvillimit dhe certifikatat e përdorimit-Kategori e pagës IV-a**

**2(Dy)Pozicione –Specialist për kontrollin e dokumentacionit të kërkesave për zhvillimin në sistemin elektronik të lejava-Kategori e pagës IV-a**

Pozicionet më sipër, u ofrohen fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se këto pozicione janë ende vakante, është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

Për të gjitha procedurat (lëvizje paralele, ngritje në detyrë) aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e dokumentave për LEVIZJE PARALELE: 27 Qershor 2019

Afati për dorëzimin e dokumentave për PRANIM NE SHERBIMIN CIVIL: 2 Korrik 2019

- **Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin Specialist për projektet e infrastrukturës dhe planifikimit të territorit :**



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA POGRADEC

- Harton studimet dhe projektimet dhe parashikon kostot e shenjave të trafikut, shenjzimeve vertikale, horizontale, impianteve të semaforëve dhe mënyrën e mirëmbajtjes së tyre, ashtu si dhe impianteve të tjera teknologjikë të destinuar për disiplinimin dhe sigurinë e trafikut;
- Siguron realizimin e investimeve publike në kohë dhe me cilësi për objektet e infrastrukturës si dhe realizimin e tyre në afatet e përcaktuara, konform kushteve teknike të projektimit dhe zbatimit sipas projekteve të miratuara, nëpërmjet monitorimit rigoroz dhe të vazhdueshëm;
- Zbaton politikat dhe strategjitë që lidhen me rrjetet e ujësjellës-kanalizimeve, rrjeteve telefonike si dhe rrjeteve elektrike si dhe administrimin sa më optimal të dokumentacionit teknik për rrjetet e mësipërme.
- Përgatit dhe propozon rekomandime për përmirësimin e shërbimit, ristrukturimit të ndërmarrjeve apo vlerësimit të mundësive të tjera duke vlerësuar partneritetin publik-privat;
- Monitoron në terren investimet, rehabilitimit riparimet në fushën e infrastrukturës dhe shërbimet e mirëmbajtjes, që realizohen nëpërmjet ndërmarrjeve të varësisë si dhe kur ato kanë nënshkruar kontrata të sipërmarrjes ose të shërbimit.

- **Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin Specialist për inspektimin e zhvillimit dhe kadastrën urbane :**

- Përditëson përgatitjen e hartave topografike hedh në hartë dhe bashkëpunon me kadastrën urbane duke hedhur objektet e reja në vijën administrative të njesisë vendore.
- Përgatit materialet e duhura për bashkëpunim për hartimin e planit që nevojitet dhe bashkëpunon me përgjegjësinë e tij.
- Përgatit dhe propozon rekomandime në lidhje me studimin e objekteve sipas kërkesave të Institucionit.
- Zbaton instrumentat e zhvillimit të territorit bazuar në ligjin për “Planifikimin e Territorit” duke u mbështetur në dokumentacionin topografik nga Kadastra Urbane dhe

<sup>1</sup>Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail: [bashkiapogradec@gmail.com](mailto:bashkiapogradec@gmail.com)



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA POGRADEC**

punon hartat mbi kufijtë administrative të njesisë vendore të paraqitura në sistemin e gjeoformimit të përcaktuara në VKM nr.495 më datë 23.06.2010” Për miratimin e standarteve të përbashkëta gjeodezike dhe GIS të regjistrit të territorit “

- Përgatit dhe materialet e nevojshme për mobilim të zonave të veçanta sipas nevojës të bashkisë

- **Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin Specialist për inspektimin dhe çertifikatat e përdorimit :**

- Është punonjës civil në vartësi direkte nga Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit.
- Kryen të gjitha detyrat e tjera të dhëna nga Drejtori që kanë të bëjnë me zbatimin praktik të ligjit për planifikimin e territorit .
- Kontrollon në mënyrë të vazhdueshme të gjitha objektet në ndërtim.
- Mban proces-verbale pas çdo faze të ndërtimit të objektit
- Njofton me shkrim Kryeinspektorin në rast të konstatimit të shkeljeve të ndryshme gjatë kontrollit.
- Jep përgjigje me shkrim brenda afatit ligjor sipas kërkesave të qytetarëve ,subjekteve apo institucioneve.
- Zbaton detyrat që rrjedhin nga zbatimi i ligjit për kontrollin dhe disiplinimin e dhënies së lejës së përdorimit.

- **Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin Specialist për kontrollin e dokumentacionit të kërkesave për zhvillim në sistemin elektronik të lejave :**

- Është punonjës civil në varësi direkte nga Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA POGRADEC**

- Studion dhe zbaton strategjitë dhe politikat në fushën Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.
- Kontrollon të gjithë dokumentacionin e depozituar në sistemin elektronik të lejave në çdo kërkesë për lejë zhvillimi ,ndërrim zgjatje afati.
- Sqaron qytetarët rreth sistemit elektronik të lejëve mbi mënyrën e aplikimit dhe dokumentacionin që ju nevojitet për të aplikuar sipas rastit.
- Jep informacion rreth PPV,PDV, infrastrukturës së parcelave që paraqiten për zhvillim.
- Është pjesë e vendimmarrjes dhe jep mendimin e tij me shkrim lidhur me aplikimet për lejë ndërtimi ,certifikata përdorimi ,shtyrje të afatit të lejës etj.
- Pjesë e grupit sipas rastit për Hartimin e projekteve të investimeve publike që kryhen në territorin e Bashkisë Pogradec.
- Pjesë e Grupit të punës për verifikim në terren ,të objekteve gjatë ndërtimit dhe raporton tek eprori për marrjen e masave në rast shkeljesh të konstatuara.
- Organizon dhe ndjek punën për koordinimin e kërkesave të subjekteve juridike apo fizike me strategjinë zhvillimit urban të qytetit.
- Jep përgjigje me shkrim brenda afatit ligjor kërkesave të qytetarëve , subjekteve apo institucioneve.
- Kryen të gjitha detyrat e tjera të dhëna nga drejtori që kanë të bëjnë me zbatimin praktik të ligjit për planifikim territori.

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA POGRADEC

### 1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

**Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:**

- a. Të jenë nëpunës civilë të konfirmuar, brenda kategorisë III-b ;
- b. Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- c. Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

**Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:**

- a. Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor".
- b. Edhe diploma e nivelit Bachelor të jetë në të njëjtën fushë.

### 1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

**Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë**

- a- Jetëshkrim i aplikantit;
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore
- f- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton dokumentet e përmendura në jetëshkrimin tuaj;

### 1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 1 Korrik 2019 Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e lëvizjes paralele, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

### 1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

**-Kandidatët për pozicionet më sipër do të vlerësohen në lidhje me:**

<sup>1</sup>Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail: [bashkiapogradec@gmail.com](mailto:bashkiapogradec@gmail.com)



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA POGRADEC

1. Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
2. Ligji nr.152/2013 “ Për nëpunësin civil “ i ndryshuar;
3. Ligji nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”
4. Ligji nr. 9131 datë 08.09.2003 “Për rregullate Etikës në Administratën Publike”
5. Ligji nr.119/2014” Për të drejtën e informimit”
6. Ligji nr.111/2018 “ Për kadastrën”

### 1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

#### **Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:**

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe certifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur proçesi i certifikimit nuk është kryer. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

#### **Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- a - Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b - Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c - Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën;

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

### 1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore e Bashkisë Pogradec do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga NJMBNJ, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

## 2. PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, këto pozicione janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

### 2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NE SHERBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA

<sup>1</sup>Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail: [bashkiapogradec@gmail.com](mailto:bashkiapogradec@gmail.com)



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA POGRADEC

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

### **Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:**

- a- Të jetë shtetas shqiptar;
- b- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

### **Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:**

a. Të ketë arsim të lartë të nivelit Bachelor.

### **2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i aplikantit;
- b- Fotokopje të diplomës ;
- c- Fotokopje e dëshmisë së gjuhës së huaj
- d- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- g- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
- h- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

### **2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Në 5 Korrik 2019 Njësia e Menaxhimit të burimeve Njerëzore do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme.

### **2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA**

**Kandidatët do të testohen me shkrim për njohuritë mbi dokumentet e listuara në pikën 1.4**

**Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC**

c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

**2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE PËR PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

a- Vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;

b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;

c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë.

**2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore do të shpallë fituesin në stendat e informimit të publikut, në faqen zyrtare të Bashkisë Pogradec dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, për rezultatet nëpërmjet (adresës së e-mail). Brenda tre ditëve kalendarike nga njoftimi individët kanë të drejtë të paraqesin ankesa me shkrim pranë zyrës së Burimeve Njerëzore.

**NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE**

MAJLINDA ÇUNI

PRANVERA SHKULLAKU

ALBANA BERBERI